

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur në Drenas, më 15.12.2025 ndërmjet:

- **KOMUNËS SË DRENASIT**, përfaqësuar nga z. Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës (mëtitje “Komuna”)

dhe

- **FONDACIONIT TË KOSOVËS PËR SHOQËRI TË HAPUR**, me seli në Prishtinë, Rruga Imzot Nikë Prela, Vila 13, Ulpianë, me numër të regjistrimit 5200001-7, përfaqësuar nga znj. Lura Limani, Drejtore Ekzekutive (mëtitje “Fondacioni”)

(më poshtë veçmas referuar si “Pala”, së bashku si “Palët”)

Neni 1

Objekti dhe Qëllimi i Marrëveshjes

1.1 Objekt i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Komunës dhe Fondacionit është përcaktimi i roleve dhe angazhimeve të ndërsjella në zbatimin e projektit të përbashkët në Komunën e Drenasit, me titull “Call for Proposals Advancing Municipal Energy Transition Sunny Schools”, i cili ka për synim angazhimin e Fondacionit për kryerjen e një investimi me qëllim instalimin e dy impianteve fotovoltaike (prodhim energjie elektrike përmes energjisë diellore) mbi ndërtesat e shkollave “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” dhe “Fehmi Lladrovci”. Sipas kushteve të thirrjes për aplikime të projektit, Komuna ka për detyrim instalimin e impiantit fotovoltaike (prodhim i energjisë elektrike përmes energjisë diellore) në ndërtesën e shkollës “Halil Bajraktari”.

1.2 Energjia elektrike që do të prodhohet nga këto impiante do të përdoret nga Komuna me qëllim për të ulur konsumin e saj të përgjithshëm nga rrjeti publik i Kompanisë Kosovare për Distributim me Energji Elektrike/Kompanisë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KEDS/KESCO) duke krijuar kështu një kursim direkt në faturat e energjisë elektrike. Ekuivalenti në EUR i sasisë së energjisë së prodhuar dhe në të njëjtën kohë të kursyer nga Komuna në një vit, do të vihet në dispozicion të nevojave të shkollave “Gjergj Kastrioti Skenderbeu”, “Fehmi Lladrovci”, dhe “Halil Bajraktari”, bazuar në projekt-idenë e paraqitur nga titullari i institucionit arsimor pas konsultimit të dokumentuar me komunitetin e shkollës.

1.3 Kjo marrëveshje ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve institucionale midis Komunës dhe Fondacionit në funksion të zbatimit të projektit “Call for Proposals Advancing Municipal Energy Transition Sunny Schools”, i cili synon angazhimin e Fondacionit për kryerjen e një investimi, që ka për qëllim instalimin e dy impianteve fotovoltaike (prodhim energjie elektrike përmes energjisë diellore) mbi ndërtesat e shkollave “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” dhe “Fehmi Lladrovci”. Sipas kushteve të thirrjes për aplikime të projektit, Komuna ka për detyrim instalimin e impiantit fotovoltaike (prodhim i energjisë elektrike përmes energjisë diellore) në ndërtesën e shkollës “Halil Bajraktari”.

1.4 Në kuadër të programit Sunny Schools, Fondacioni përmes organizatës Kantar Index Kosova, do kryejë vlerësim kuantitativ të shkollave ku do bëhet investimi, si dhe në shkolla ku nuk do bëhet investimi (grup kontrolli). Ky vlerësim ka për qëllim matjen e ndikimit të investimit të teknologjisë fotovoltaike në rezultatet shkollore, autonominë e shkollave, dhe angazhimin e hisedarëve. Gjithashtu, Fondacioni përmes organizatës BONEVET, do angazhojë komunitetin e shkollave përmes edukimit, angazhimit, dhe ngritjes së njohurive dhe praktikave lidhur me tranzicionin energjetik dhe demokratizimin e energjisë në komunitete lokale.

Neni 2

Rolet dhe Përgjegjësitë e Palëve

2.1 Fondacioni merr përsipër:

- a. Të ofrojë mbështetje financiare për kryerjen e investimit në instalimin e dy impianteve fotovoltaike (prodhim energjie elektrike përmes energjisë diellore) në ndërtesat e shkollave të përmendura më sipër, duke përfshirë funksionimin dhe mbarëvajtjen për një periudhë dy vjeçare. Investimi për instalimin e impianteve fotovoltaike do të realizohet nëpërmjet subjekteve të treta, të cilat nuk janë palë në këtë marrëveshje, nëpërmjet identifikimit, prokurimit dhe kontraktimit të tyre nga ana e Fondacionit.
- b. Të angazhohet që investimi të sigurojë standard të lartë teknik dhe të vendosë në dispozicion të të gjitha palëve të interesuara informacion të plotë mbi investimin e kryer.
- c. Të njohë të drejtën e pronësisë Komunës mbi impiantet fotovoltaike pas realizimit të investimit. Fondacioni do të ketë të drejtën e përdorimit e dy impianteve fotovoltaike deri në datën 31.12.2027, ndërkohë që menjëherë mbas kalimit të këtij afati, Fondacioni do të kryejë dorëzimin e këtij investimi tek Komuna.
- d. Të kontribuojë në ngritjen e kapaciteteve të mësuesve të shkollave të sipërpërmendura dhe komunitetin për rëndësinë e sistemeve të energjisë së ripërtërishme në veçanti, e ne përgjithësi të mbrojtjes së mjedisit, ndryshimeve klimaterike dhe ekonomisë qarkulluese, përmes organizatës Bonevet, në momentin e fillimit të projektit Green Generation.
- e. Të promovojë këtë investim, si mundësi dhe model i ri zhvillimi në punën me institucionet shtetërore dhe donatorët e tjerë.
- f. Të bashkëpunojë me Komunën për identifikimin e mundësive dhe burimeve të financimit për kryerjen e investimeve të ngjashme në territorin e saj.
- g. Të sigurojë dhe të ndajë me Komunën një kopje të raporteve dhe të ofrojë informacion periodik mbi ecurinë e zbatimit të projektit dhe të dhënat e gjeneruara prej tij.
- h. Të bashkëpunojë me Komunën për hartimin e një plani të përbashkët veprimi për të siguruar vazhdimësinë e Projektit edhe pas përfundimit të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi.

2.2 Komuna merr përsipër:

- a. Të angazhohet që të lehtësojë procedurat administrative që lidhen me marrjen e lejeve për të kryer investimin, ndër tjera:
 - i. Të sigurojë Certifikatat e Pronësisë për të gjitha objektet e shkollave të sipërpërmendura dhe të garantojë që pronësia e tyre i takon plotësisht Komunës së Drenasit.
 - ii. Të komplotojë të gjithë dokumentacionin e duhur për pëlqimin e Komunës për Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE).
 - iii. Të sigurojë dokumentacionet shtesë për marrjen e lejeve të investimit nga palë të treta (KEDS/KESCO) dhe tjera.
- b. Komuna përmes njësive – Drejtorive përkatëse relevante do:
 - i. Të marrë në dorëzim dhe kalojë në inventar të saj këtë investim, pas dorëzimit të tij nga Fondacioni.
 - ii. Të mirëmbajë në vazhdimësi investimin e kryer nëpërmjet këtij projekti në të gjashtë shkollat në kuadër të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi.
- c. Komuna përmes njësive – Drejtorive përkatëse relevante do:
 - i. Të ndjekë zbatimin e projektit, koordinimin dhe mbarëvajtjen e tij përgjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes së Bashkëpunimit.
 - ii. Të mbajë marrëdhënie të vazhdueshme me komunitetin e zonës, ku do të kryhet investimi dhe të lehtësojë procesin e komunikimit dhe konsultimit të ekipit të projektit me banorët dhe aktorët e tjerë të përfshirë.
 - iii. Të ju japë lejet relevante organizatës Kantar Index Kosova për të kryer vlerësimin kuantitativ në shkollat ku do bëhet investimi, por edhe në shkolla ku nuk do bëhet, për t'i shërbyer vlerësimit të investimit.
 - iv. Të ju japë lejet relevante organizatës BONEVET për të kryer aktivitetet e edukimit dhe angazhimit të komunitetit, në shkollat ku do bëhet investimi.
 - v. Të sigurojë pjesëmarrjen aktive në “Forum Komunitar të Shkollave” që do të organizohet për menaxhimin efikas të investimit.
 - vi. Të promovojë këtë investim si mundësi dhe model të ri zhvillimi brenda shërbimeve të ofruara nga Komuna, por edhe më gjerë.
- d. Të instalojë impiantin fotovoltai (prodhim i energjisë elektrike përmes energjisë diellore) në ndërtesën e shkollës “Halil Bajraktari”, sipas kushteve të thirrjes për aplikime të projektit. Fondacioni do ofrojë projektin teknik edhe për këtë shkollë, për të cilën Komuna mban përgjegjësi për proceset implementuese (instalimin e impiantit).
- e. Të kontribuojë në identifikimin e mundësive dhe burimeve të financimit për kryerjen e investimeve të ngjashme në territorin e Komunës dhe të iniciojë grupe pune përkatëse.
- f. Të koordinojë procesin me dy shkollat për të rregulluar kushtet dhe mënyrën e transferimit/shfrytëzimit të fondit që do të kursehet nga fatura e energjisë dhe përcaktimin e përgjegjësisë të shkollës në administrimin e fondit/shpenzimit, parandalimin e shpërdorimit të energjisë dhe mbajtjes së komunikimit me komunitetin shkollor në funksion të zbatimit të projektit.

- g. Të shqyrtojë projekt-idetë e paraqitur nga shkollat e sipërpërmendura dhe të miratojë shumën për shpenzim, ekuivalente me kursimin në një vit nga prodhimi i energjisë elektrike, e cila alokohet në buxhetin vjetor të shkollave. Shkollat do të dorëzojnë projekt-idetë në muajt shtator-tetor të çdo viti.
- h. Të përdorë energjinë e prodhuar nga impiantet sipas mënyrës së parashikuar në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi edhe pas datës 31.12.2027 (periudhë në të cilën impiantet do t'i kalojnë në dorëzim Komunës nga Fondacioni).
- i. Të njohë të drejtën e Fondacionit për të përdorur impiantet fotovoltaike në funksion të projektit dhe kushteve parashikuar në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi deri në datën 31.12.2027.

2.3 Detyrime të përbashkëta të palëve:

- a. Komuna në bashkëpunim me Fondacionin, do të komunikojë me KEDS/KESCO me qëllim arritjen e një marrëveshje të "net billing" të energjisë, e cila bën të mundur që çdo njësi (kWh) energji elektrike që do të injektohet në rrjetin publik të KEDS/KESCO do t'i njihet Komunës dhe do t'i paguhet.
- b. Nëse nuk do të arrihet marrëveshja e mësipërme, mbiprodhimi i energjisë krijuar për shkak të energjisë që nuk do të konsumohet nga shkolla, do të transferohet falas në rrjet në favor të KEDS/KESCO.
- c. Për menaxhimin efikas të investimit Fondacioni me Komunën do të krijojnë "Forumin Komunitar të Shkollave", i cili përbëhet nga përfaqësuesi i Komunës, përfaqësuesi i Fondacionit, një përfaqësues nga stafi menaxherial i secilës shkollë dhe një përfaqësues i komunitetit të prindërve për secilën shkollë. Forumi drejtohet nga përfaqësuesi i Komunës. Forumi mbledhet të paktën 2 herë në vit dhe diskuton mbi mbarëvajtjen e projektit dhe i paraqet një raport periodik Komunës dhe Fondacionit për ecurinë e projektit. Raporti mund të paraqesë rekomandime për përmirësimin e zbatimit të projektit. Forumi ka për detyrë trajtimin e ankesave të mundshme që mund të paraqiten nga komuniteti i shkollës.
- d. Fondacioni dhe Komuna përjashtohen nga çdo përgjegjësi për humbjet dhe dëmet financiare që mund t'i shkaktohen palëve në rast se nuk përmbushet objekti i Marrëveshjes së Bashkëpunimit. Gjithashtu, në rast se ndodhin dëmtime të gjërave të luajtshme ose të paluajtshme, ose të subjekteve të treta gjatë ndërtimit të impianteve ose pas përfundimit të projektit, Fondacioni dhe Komuna do të përjashtohen nga çdo përgjegjësi dhe përgjegjës për dëmin e shkaktuar do të jetë subjekti privat i cili do të realizojë ndërtimin e impianteve (detyrime të cilat do të saktësohen në kontratën e lidhur midis subjektit privat dhe Fondacionit).

Neni 3

Kohëzgjatja dhe Hyrja në Fuqi

4.1 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj nga palët dhe do të jetë e vlefshme deri në datën 31.12.2027.

Neni 4

Zbatimi dhe Zgjidhja e Marrëveshjeve

5.1 Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, për të qenë partnerë në zbatimin e projektit dhe të punojnë së bashku për realizimin me sukses të aktiviteteve të tyre.

5.2 Palët angazhohen që t'i zgjidhin mosmarrëveshjet vetëm eskuzivisht me mirëkuptim në mbështetje të interesit më të lartë publik e shoqëror.

5.3 Në rast se zgjidhja e mosmarrëveshjes me mirëkuptim nuk do të rezultojë e mundur, atëherë palët drejtohen për zgjidhje pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Neni 5

Personat e Kontaktit

6.1 Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis palëve në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, qofshin me gojë apo me shkrim, si elektronike ashtu edhe të shtypura në letër, i drejtohen personalisht personave të kontaktit përcaktuar nga secila nga palët, si më poshtë vijon:

a. Për Komunën:

Adresa: Rruga Fehmi Lladrovci, Drenas

Emri dhe pozita e personit të kontaktit: Afrim Prokshi,

E-mail: afrim.prokshi@rks-gov.net / Telefoni: 044 170 784

b. Për Fondacionin:

Adresa: Rruga Imzot Nikë Prella, Vila 13, Ulpianë, 10000, Prishtinë

Emri dhe pozita e personit të kontaktit: Adea Kondirolli, Menaxhere e Projekteve, KFOS

Email: adea.kondirolli@osfwb.org/ Telefoni: 049 665 373

6.2 Këta persona do të jenë përgjegjës për saktësinë e protokolleve, proces-verbaleve, listave dhe çdo dokumenti shoqërues që ka të bëjë me përgatitjen dhe miratimin e Projektit.

6.3 Në rast të ndryshimit të njërit nga këta persona, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda një jave kalendarike për të dhënat e personit të ri të kontaktit.

Neni 6

Dispozita të Fundit

7.1 Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, për realizimin e bashkëpunimit në funksion të arritjes së qëllimit të kësaj marrëveshjeje.

7.2 Ngarkohen Komuna e Drenasit respektivisht njësitë – drejtoritë përkatëse dhe të tjera struktura përbërëse për zbatimin e detyrave të parashikuara në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi.

7.3 Çdo rregullim ose ndryshim në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, mund të kryhet vetëm me shkrim dhe nëpërmjet pëlqimit reciprok të palëve.

7.4 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është përgatitur në 4 (katër) kopje, 2 (dy) për Komunën dhe 2 (dy) për Fondacionin.

Për Komunën

Ramiz Lladrovci



Kryetar i Komunës së Drenasit

Për Fondacionin

Lura Limani

Drejtoreshë Ekzekutive KFOS